



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr.07
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302
Prishtinë, më 28 qershor 2021, në orën 11:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë : Fatmire Kollçaku, Armend Zemaj, Labinotë Demi- Murtezi, Haxhi Avdyli, Mirsad Shkreta, Burim Karameta, Bekim Haxhiu, Shemsedin Dreshaj, dhe Samra Ilijazi, anëtarë.

Munguan: Miljana Nikoliq dhe Uran Ismaili, anëtarë.

Stafi mbështetës: Shpresa Haxhijaj, koordinatore dhe Besim Haliti, zyrtar i lartë i fushës/analist.

Pjesëmarrës të tjerë: Granit Bllaca, KDI; Violeta Salihu, KSH dhe përfaqësuesit e mediave (gazetarët).

Mbledhjen e kryesoi Fatmire Kollçaku, kryetare e komisionit.

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Raportim i grupeve punuese për monitorim;**
- 3. Përgatitje për tryezën për të drejtat dhe sigurinë e pacientëve;**
- 4. Të ndryshme.**

2. Raportim i grupeve punuese për monitorim

Fatmire Kollçaku tha ashtu siç jeni të informuar grupet punues, veç kanë filluar punën e tyre në vizita nëpër terren dhe tani duhet ta përshpejtojnë punën e tyre, pastaj për t' i paraqitur të gjeturat më anë të rekomandimeve. Ajo tha që për Ligjin për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID

-19, në territorin e Republikës së Kosovë, është kryesues, deputeti Bekim Haxhiu, të cilit ia kaloi fjalën për ta paraqitur punën e grupit punues.

Bekim Haxhiu tha që në vizitën që ishim në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, aty kemi biseduar lidhur mbikëqyrjen e Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID -19, se sa është duke i zbatuar ky ligj, dhe nga ty i kemi marrë informatat nga drejtori i IKPSH-së z. Naser Ramadani, për sfidat më të cilat janë ballafaquar që nga fillimi i përhapjes së pandemisë dhe deri më tani stafi i IKPSH-së. Ai theksoi se në bazë të Plani të veprimit për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, do caktojmë agjendën për vizita në terren do t'i vizitojmë disa prej spitaleve rajonale siç janë: Spitali i Pejës dhe i Mitrovicës, inspektoratin e punës dhe të shëndetësisë dhe institucionet tjera që kanë pasur dhe kanë të bëjnë më menaxhimin e pandemisë COVID -19.

Fatmire Kollçaku propozoi që kur të vizitohen spitalet rajonale, njëkohësisht të vizitohen drejtorit komunale të shëndetësisë dhe Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF-et).

Haxhi Avdyli tha sa i përket Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID -19, ka qenë i nevojshëm kohën kur është miratuar, ndërsa tani janë bërë disa evoluime dhe kanë ndryshuar disa gjera, prandaj monitorimi është në kohën e duhur, sidomos rrethë gjobave së çfarë efekti kanë dhanë, po ashtu lidhur më vaksinimin gjatë mbikëqyrjes, le ta shohim se a ka nevojë të stimulohen qytetaret për vaksinim, pastaj nëse paraqiten këto problem dhe sfida, mund të rekomandojmë plotësim ndryshimin e këtij ligji.

Shemsedin Dreshaj tha se pajtohet më kolegët deputet që pasi monitorimit të rekomandohet plotësim ndryshimi i Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID -19, te pjesa e vaksinimit ta gjejmë një metode që vaksinimi të behet i detyrueshëm, pasi që një pjesë e popullatës po hezitojnë të vaksinohen.

Armend Zemaj tha që grupet punues për monitorimi duhet më qenë më dinamike dhe të dalim në vizita nëpër terren, në mënyrë që ta përfundojmë sa më shpejt mbikëqyrjen, derisa nuk kemi në pritje projektligje për shqyrtim. Ndërsa sa i përket Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID -19 lidhur më procesin e vaksinimit, tha që promovimi po ju mungon shumë, sepse nuk ka as fushat sensibilizuese.

Bekim Haxhiu theksoi së raportin përfundimtar me rekomandimet do t'i nxjerrin pasi përfundimit të mbikëqyrjes së ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID -19.

Fatmire Kollçaku tha se për Ligjin për shëndetin mendor, kryesues i grupit të punës është deputeti, Burim Karameta, të cilit ia kaloi fjalën për ta prezantuar, punën e grupit punues.

Burim Karameta tha që grupi i punës për monitorimin e Ligjit për Shëndetin Mendor, e ka pasur një takim punë me përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, në atë takim jemi takuar me sekretarin e kësaj ministrie, z. Naim Bardiqi, dhe me zyrtarët e Komisionit Psikiatrik- ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë, ku temë e diskutimit, ka qenë zbatimi i Ligjit për Shëndetin Mendor dhe nxjerrja e akteve nënligjore dhe në fund të takimit përfaqësuesit e MSH-së, na kanë kërkuar që për pyetjet e parashtruara t' ju jepet një javë kohë, afat për të hartuar Raportin më shkrim dhe për t' u përgjigjur në pyetjet e bëra për zbatimin e ligjit të shëndetit mendor. Ai theksoi se grupi punues do ta vazhdojë punën e tyre në bazë të planit të veprimit, që i ka të planifikuar lidhur me takimet dhe vizitat në institucionet përkatëse që kanë të bëjnë më zbatimin e këtij ligj.

Shemsedin Dreshaj propozoi që se pari ta pësimi raportin më shkrim që ishim nga vizita në Ministrinë e Shëndetësisë se ku janë problemet dhe sfidat në zbatimin e Ligjit për shëndetin mendor, pastaj e kemi më të lehtë orientimin mbikëqyrjes nëpër institucionet e tjera përkatëse.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë:

Konkluzion

Grupet punese për monitorim të ligjeve të vazhdojnë punën e tyre në baze të Planit të Veprimit

3.Përgatitje për tryezën për të drejtat dhe sigurinë e pacientëve

Fatmire Kollçaku: Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, tha se ka kohë që kjo çështje është ngritur edhe këto të drejta janë të obliguar që të gjitha institucionet shëndetësore t'i respektojnë. Ajo theksoi se ka Shoqata që merren më drejtat e pacientëve, por është mirë që këto të drejta të merren në mbrojtje nga vetë institucionet shtetërore përkatëse, siç janë: siguria, mbrojtja dhe konsumatori, lidhur më këto tema propozoi që ta përgatitemi një dëgjim publik më temën për të drejtat dhe sigurinë e pacientëve. Ku në këtë organizim të kësaj tryeze, të ftohen institucionet përkatës dhe shoqatat që merren me të drejtat e pacientëve, organizata për mbrojtje të konsumatorit, dhe palët e tjera që merren më këto problem, në mënyre që t'i dëgjojmë gjitha palët dhe të trajtohen këto problem, pastaj mund nxjerrim konkluzionet dhe t'ju rekomandojmë institucioneve përkatës që t'i respektojnë të drejtat dhe sigurinë e pacientëve.

Haxhi Avdyli, lidhur më këtë çështjet, tha që kemi një Ligj që nga viti 2004 që është për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor, dhe që nga kjo kohë ky ligj nuk është plotësuar dhe as ndryshuar. Prandaj është mirë që të e trajtojmë edhe bazën ligjore, sepse shumë gjëra kanë ndryshuar që nga ajo kohë, kanë nevojë të plotësohet dhe harmonizohet edhe më ligjet e tjera. Propozoi që në organizimin e dëgjimit publik për këtë temë të ftohen dhe përfaqësuesit e Shoqatës së të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK, pasi që për një kohë të gjatë merren më të drejta e pacientëve

Komisioni unanimisht vendosi, që të organizohet dëgjim publike për të drejtat dhe sigurinë e pacientëve

4.Të ndryshme

Bekim Haxhiu tha që e ka pranuar kërkesë nga Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, lidhur më ndërprerjen e shtesave në pagë të ndara për punëtorët shëndetësorë të punësuar në sektorin publik që janë të rregulluara me Ligjin për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës. Dhe për këtë çështje kërkoi që Komisioni të kërkoi informata nga Ministria e Shëndetësisë, për të e sqaruar pse ju janë ndërprerë këto shtesa, për ndërsa ky ligj nuk shfuqizohet deri në ditën e shpalljes së përfundimit të pandemisë COVID-19 nga Qeveria e Republikës së Kosovës, kjo shtesë ju takon si kompensim më nenin 20 të paragrafi 1, ndërsa të përfundon pandemia.

Fatmire Kollçaku tha se po sa ta pranojmë kërkesën në mënyrë zyrtare nga Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, komisioni do të kërkojë informatë për të na sqaruar se ku është

problemi, tani siç dihet Ligji për buxhetin e Shtetit, është duke u rishqyrtuar dhe kjo mund të jetë arsyeja e ndërprerjes së shtesave, për një kohe të caktuar.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40.

E përgatiti: Staf i mbështetës i Komisionit

Fatmire Kollçaku,

Kryetare e Komisionit